

**VENDIM**  
**Nr. 122, datë 13.3.2019**

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR  
AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE E POSTARE,  
PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), për vitin 2019, në shumën 378 360 000 (treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

## PASQYRA NR. 1

PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E  
POSTARE PËR VITIN 2019

<b>Të ardhura</b>	<b>Në mijë lekë</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>Në mijë lekë</b>
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	160 000	Shpenzime personeli	114 049
Të ardhura nga pagesa për frekuencat	132 000	Shpenzime për sigurimet shoqërore e shëndetësore	14 751
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26 000	Shpenzime për materiale	8 730
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20 160	Shpenzime për shërbime	148 914
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	8 500	Shpenzime për investime	91 916
Të ardhura nga pagesa për domain	8 000		
Të ardhura nga pagesa të tjera	700		
Të ardhura nga agjenti tatimor	23 000		
<b>Total i të ardhurave</b>	<b>378 360</b>	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>378 360</b>

